



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER

Nr. 909 prot.

Fier më 23/01/2026

PROJEKT – VENDIM

Nr. 04, datë 23/01/2026

“Për shtimin në listën e përfituesve të bursave të shtetit, për nxënësit që ndjekin programet mësimore në arsimin bazë , të mesëm, dhe arsimin e mesëm profesional për vitin arsimor 2025 -2026”, për të cilin është miratuar Vendimi I Këshillit Bashkiak nr. 122 , datë 22.12.2025” , të disa nxënësve përfitues”

Këshillit të Bashkisë Fier, sot më datë/..../2026, i paraqitet materiali, nga Grupi i Punës, i ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë Fier, Nr.458, Datë 10.10.2025 “Për shqyrtimin e dokumentacionit për studentët dhe nxënësit aplikant për të përfituar bursë”, bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, pika k , neni 54, në Ligjin nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”; kritereve të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.666 datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave dhe pagesave për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike” i ndryshuar, korrespondencave zyrtare me ministritë përkatëse, si dhe shqyrtimit të kërkesave zyrtare të paraqitura pranë Bashkisë Fier, bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 54, pika k, ekzekutivi i Bashkisë,

PROPOZON:

1. Të shtojë në listën e përfituesve të bursave të shtetit, për nxënësit që ndjekin programet mësimore në arsimin bazë , të mesëm, dhe arsimin e mesëm profesional për vitin arsimor 2025-2026”, për të cilin është miratuar Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 122 , datë 22.12.2025”, si më poshtë:

- **Nxënësi, Niko Stefan Shtrepi** – Shkolla e mesme e përgjithshme “Perikli Ikonimi”, klasa e 10, përfitues bazuar në pikën 2, Kriteri 2.3 Kriteri joekonomik, gërma d) *Nxënësit, fëmijë të personit/personave që gëzojnë statusin e invalidit/ njëri prej prindërve invalid*

- **Nxënësi, Florjan Gezim Buzi** – shkolla 9 vjecare e bashkuar “Jovan Ndreko”, Njësia Administrative Libofshë, klasa e 9, përfitues bazuar në pikën 2, Kriteri 2.3 Kriteri joekonomik, gërma c) *Nxënësit, të cilët gëzojnë statusin ligjor të invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, si dhe aftësi të kufizuara,, të vërtetuar nga komisioni mjekoligjor/ vet nxënësi.*
 - **Nxënësi, Stiven Selami Buzarakaj** – Shkolla e Mesme “Janaq Kilica”, Kriteri joekonomik, gërma g) *Nxënësi me një prind, njëri prej prej prindërve nuk jeton/me një prind.*
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Ekzekutivi i Bashkisë Fier dhe Institucionet Arsimore perkatëse.

Komisioni për shqyrtimin e dokumentacionit për bursa

Olta Brahusi

Selnada Tyto

Ermioni Gazeli

Drejtoria Juridike
Drejtor
Esmeralda Kapllanaj

Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit
Drejtor
Pranvera Çina

KRYETAR
Armando Subashi

